



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1029
Dt 15.09.2015

Në bazë të nenit 50, pika 2, nenit 93, pika 2, nenit 94 dhe 95 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 10.9.2015, mori:

VENDIM

- I. Për emërimin e Komisionit të Studimeve të Senatit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”.
- II. Komisioni ka këtë përbërje:
 - Izet Zeqiri-kryetar;
 - Musa Rizaj- anëtar;
 - Islam Fejza-anëtar;
 - Aziz Behrami-anëtar;
 - Fatbardha Hoxha-anëtar;
 - Bashkim Preteni-anëtar;
 - Besart Hajrizi- anëtar,
 - Valon Sherifi-anëtar;
 - Lorita Bejtullahu-anëtar.
- III. Në bazë të Statutit të Përkohshëm, neni 94, Komisioni i studimeve është përgjegjës për: Hartimin e propozimeve të programeve të reja të studimeve; Përshtatjen dhe ndryshimin e programeve ekzistuese të studimit; Rishikimin e vazhdueshëm të teksteve universitare; Kërkesat për ndërrimin e programeve të studimeve nga studentët; Kërkesat për “studium irregulare” nga studentët; Përgatitjen e lëndës për ankesat e studentëve; Vlerësimin e studentëve.
- IV. Detyrat e Komisionit të studimeve janë: zhvillimi i koncepteve, vlerësimi dhe komentimi i kërkesave në mënyrë që të përgatis raporte për të cilat vendoset në Senat.
- V. Kohëzgjatja e mandatit të Komisionit të studimeve është në pajtim me rregulloret e Senatit për anëtar.
- VI. Vendimi hyn në fuqi nga dita e miratimit.

Arsyetim

Senati i Universitetit, duke pasur parasysh propozimet e njësive akademike dhe përfaqësimin e drejtë të secilës njësi akademike në këtë Komision, mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t’i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Anëtarëve të Komisionit,
3. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rëktor i UMIB-it